



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1145/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Burim Ademi - kryesues, Adnan Konushevi dhe Zyhdi Haziri, anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 3166-2021 i datës 20.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale 2021, për Kryetar Komune në Prizren, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 23.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet i pabazuar pjesa e apelit, Anr.1145/2021 e datës 21.11.2021, i paraqitur nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, me të cilin ka kërkuar që në Vendvotimet: 2001A/02R, 2002A/05R, 2003A/07R, 2005X/04R, 2005X/06R, 2006A/01R, 2006X/01R, 2020A/01R, 2023A/01R, 2023A/02R, 2030A/02R, 2033A/04R, 2035A/02R, 2042A/02R, 2042A/06R, 2042A/09R, 2042A/11R, 2026A/01R, 2026A/02R, 2026A/03R, 2042A/03R, 2030A/01R dhe në Qendrën e Votimit të fshatit Hoqë e Qytetit, të anulohet rezultati i publikuar dhe të urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ta organizoi rivotimin, si shkak i diferencës së daljes së votuesve për të votuar dhe fletëvotimeve në kutitë e votimeve.

II. HUDHET i pasafatshëm pjesa apeli Anr.1145/2021 e datës 21.11.2021, i paraqitur nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, kundër vendimit me numër 3166-2021 i datës 20.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale 2021, në pjesën që pretendon apeluasi për parregullsitë e paraqitura gjatë ditës së votimit të datës 14.11.2021.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 21.11.2021, ka pranuar apelin Anr.1145/2021 të paraqitur nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendon se Vendvotimet: 2001A/02R, 2002A/05R, 2003A/07R, 2005/04R, 2005X/06R, 2006A/01R, 2006X/01R, 2020A/01R,

2023A/01R, 2023A/02R, 2030A/02R, 2033A/04R, 2035A/02R, 2042A/02R, 2042A/03R, 2042A/06R, 2042A/09R, 2042A/11R, 2026A/01R, 2026A/02R, 2026A/03R, 2042A/03R, 2030A/01R dhe në Qendrën e Votimit të fshatit Hoqë e Qytetit, si shkak se më pak ka votues që kanë dalë për te votuar sesa vota në kutitë e votimit prandaj sipas apeluesit kutitë e votimit janë mbushur kundërligjshëm. Mëtej apeluesi pretendon se nga deklaratat e dëshmitarëve okular dhe fotove të bëra në ditën e zgjedhjeve, qartazi shihet se nga anëtarë militant simpatizantët në shoqërim dhe të personave të tjerë të panjohur për apeluesin ka pasur kërcënime për përdorim të dhunës, shantazh e që të njëjtit janë inkurajuar, mbështetur nxitur e motivuar nga figura të njohura të PDK-së dhe subjektit politik Koalicija Vakati, por edhe subjekteve të tjera të cilët mbajnë poste të larta brenda këtyre subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Në QV të gjimnazit “Gjon Buzuku” gjatë gjithë kohës në ditën e zgjedhjeve, zyrtari i lartë i subjektit politik “Nisma” Gani Gërmizaj, ka ushtruar ndikim dhe presion mbi votuesit si dhe dyshohet që personave të ndryshëm iu ka ofruar edhe para për blerjen e votave. Në QV në Has konkretisht në QV në Gjonaj dhe Dedaj zyrtarët e Nisma-s dhe të AAK-së Shukri Qunaj dhe Ilir Baldedaj, gjatë gjithë kohës kanë bërë presion mbi votuesit duke bërë trysni për votim të kandidatit të PDK-së Shaqir Totaj. Në QV në lagjen Ortakoll, zyrtarët e PDK-së Agim Zogaj dhe Sadik Paqarizi, gjatë gjithë kohës kanë bërë presion mbi votuesit madje edhe brenda këtyre QV duke bërë trysni për votim të kandidatit të PDK-së Shaqir Totaj. Në QV në fshatrat Vlashnje dhe Kobaj biznesmeni i afërt me PDK-në Tefik Tarashaj gjatë gjithë kohës ka bërë presion mbi votuesit duke iu bërë trysni votuesve për votim të kandidatit të PDK-së Shaqir Totaj, po ky person ka lëvizur edhe në QV e tjera të rajonit të Zhupës. Në shkollën teknike “11 Marsi” në Prizren Njësia e Agjencisë së Veterinës dhe Ushqimit të Kosovës, në mënyre sistematike ka ndërhyrë në këtë shkollë duke u mbajtur procesi zgjedhor ku në këtë rast kanë kërkuar nga qytetarët vendosjen e maskave për të hyrë në shkollë dhe për të votuar. Në QV në gjimnazin “Remzi Ademaj” ka pasur tendencë të krijimit të situatës së frikës në këtë QV, për shkak se është i njohur fakti se shumica e votuesve në këtë QV, votojnë kryesisht për LVV, e kjo është bërë përmes thirrjes së urgjencës shëndetësore dhe të policisë në disa raste ku të njëjtit kanë ardhur me alarme të ndezura dhe kanë krijuar panik të shumtë të qytetarët votues ku shumë prej tyre janë larguar pa votuar fare. Ndërsa në QV në Vlashnje gjatë gjithë ditës njësitë e KEDS-it, kanë qëndruar pa asnjë arsye dhe asnjë arsyetim gjë që shton dyshim për keqpërdorim të KEDS-it dhe është dëshmi e qartë e ndikimit të kundërligjshëm të personave të paautorizuar në procesin e votimit në këtë QV. Në QV 2002A në shkollën fillore “Ibrahim Fehmiu” në lagjen Arbanë sipas pretenduesit të apelit persona të panjohur kanë votuar në mënyrë të kundërligjshme në emër të personave që jetojnë jashtë Kosovës, ku konkretisht një person i panjohur është nënshkruar në emër qytetares Nazmije Demiraj, cila

jeton në Gjermani dhe në ditën e zgjedhjeve nuk ka qenë fare në Kosovë. Gjatë ditës së zgjedhjeve funksionarë të lartë të PDK-së (Sami Lushtaku, Adem Grabovci, Njizai Kryeziu dhe Shaqir Totaj) militantë, aktivistë dhe simpatizantë të subjekteve PDK (Njizai Pajaziti, Lumni Lushar, Nezir Qoqaj dhe Vexhi Halili), NISMA (Zafir Berisha) AAK dhe të Vakut (Bahrim Shabani) dhe persona të tjerë në shoqërim të tyre (Amir Rustemoviq, Rexhep Kuliqi, Rafit Kurtishi, Faik Haziri dhe komandanti i Policisë në Reçan Tefik Tarashaj, duke ndenjur në grupe të mëdha pranë QV dhe brenda QV-ve, deri në 50 persona duke i bllokuar rrugët me automobilot e tyre dhe penguar qytetarët që të shkojnë në vendvotime, e po ashtu deputetë të Kuvendit të Kosovës si Bahrim Shabani dhe funksionarë të Policisë së Kosovës, sikurse komandantit i stacionit të Policisë Xhemajl Asllani ka kërcënuar qytetarët me përdorim të dhunës dhe kanë blerë vota ose kanë ndërmjetësuar për blerje të votave të qytetarëve në shumën prej 30 deri në 50 euro. Me propozim për panelin që të urdhërojë KQZ-në, për rivotimin e të gjitha Vendvotimeve të cekura si në apel, duke ja bashkangjitur apelit, listën e këtyre vendvotimeve të paraqitur me tabelë me numër të qytetarëve që kanë dalë për të votuar dhe numrin e nënshkrimeve në listën e votuesve të raportuar nga KQZ-ja, si dhe diferencën e më shumë ose më pak nënshkrime të dalja e raportuar, Listën e përpiluar në bazë të raportit të KQZ-së, 15 Foto dhe 15 deklaratat të vëzhguesve, komisionerëve si dhe qytetarëve.

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet e apeluesit, që kanë të bëjnë me diferencën e fletëvotimeve ndërmjet të daljes së votuesve për të votuar dhe fletëvotimeve që gjendet në kutit e votimit e që janë publikuar me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar për rundin e dytë të zgjedhjeve lokale 2021, për Kryetar Komune në Prizren, gjeti se apeli i apeluesit në këtë pjesë është i pa bazuar dhe vendosi si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, për këto arsye:

Pretendimet e apeluesit se në Vendvotimet dhe Qendrën e Votimit, të cekur si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, se ka pas mbushje të kundërligjshme të kutive të votimit sepse gjatë ditës së votimit është raportuar nga KQZ-ja, se ka numër më të vogël të daljes së votuesve e ndërsa me rastin e publikimit të rezultatit përfundimtar, ka rezultuar sipas apeluesit se ka më shumë fletëvotime sesa dalje të votuesve. Paneli i vlerëson se këto pretendime se janë në tërësi të paqëndrueshme ngase me asnjë provë shkresore siç janë librat e votimit, në të cilat raportohet-shkruhet tërë mbarëvajtja e procesit të votimit, nuk rezultojnë në asnjë Vendvotim apo Qendër të Votimit, se kemi të bëjmë me mbushje të kundërligjshme të kutive të votimit. Për më tepër paneli vlerëson se të gjitha raportimet e KQZ-së, për daljen e votuesve për të votuar gjatë ditës së votimit, dhe fillim i shpalljes së rezultateve menjëherë pas mbylljes së Qendrave të Votimeve, janë të dhëna preeliminare që nënkuptojnë se janë të

ndryshueshme në vazhdimësi, përderisa të shpallet rezultatit përfundimtar i zgjedhjeve. Prandaj këto pretendime të ankuesit duke u mbështetur në statistika preliminare të KQZ-së, janë bazë e paqëndrueshme për të vendosur ndryshe me atë se si është vendosur në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi. Siç rezulton nga materiali zgjedhor me saktësisht nga FPR e të gjitha vendvotimeve të pretenduara nga apeluesi, qartësisht rezulton se të dhënat e nënshkrimeve në listën e votuesve dhe fletëvotimet në kutitë e votimit janë në përputhshmëri të plote, përveç në dy vendvotime, dhe atë: 2020a/01R që nga FRP rezulton se janë gjithsejtë 209 nënshkrime në listën përfundimtare të votuesve, ndërsa rezulton se numri i fletëvotimeve brenda kutisë së votimit është 210, megjithatë në rezultat si të vlefshme rezulton se janë vetëm 206 fletëvotime ndërsa 4 fletëvotime të pavlefshme çka rezulton se numri i fletëvotimeve në rezultat përfundimtar sipas FRP në këtë vendvotim është me i vogël se sa numri i nënshkrimeve e kjo për shkak të pavlefshmërisë së 4 fletëvotimeve, po ashtu 2002A/05R që nga FRP rezulton se janë gjithsejtë 274 nënshkrime në listën përfundimtare të votuesve, ndërsa rezulton se numri i fletëvotimeve brenda kutisë së votimit është 275, megjithatë në rezultat si të vlefshme rezulton se janë vetëm 273 fletëvotime ndërsa 2 fletëvotime të pavlefshme çka rezulton se numri i fletëvotimeve në rezultat përfundimtar sipas FRP në këtë vendvotim është me i vogël se sa numri i nënshkrimeve e kjo për shkak të pavlefshmërisë së 2 fletëvotimeve, andaj edhe për shkak të këtyre të dhënave në këto dy vendvotime është e qartë se nga të gjitha FRP-te tjera të verifikuara nga Paneli, nuk rezulton që ka mospërputhje në raport me votuesit dhe votat e këtyre dy vendvotimeve që janë përfshirë në rezultat përfundimtar. Për këto arsye në kuptim të nenit 117 par 3, e cila dispozite përcakton se vendimet e panelit duhet të mbështeten në dëshmi të qarta dhe bindëse, për panelin në këto rrethana qartësisht nuk provohen pretendimet e apeluesit në dëshmi të tilla siç dispozita ligjore e përcakton.

Për më tepër në materialet e dorëzuara nga KQZ-ja, e që rrjedhe nga raporti i ditës së zgjedhjeve i datës 14.11.2021, sipas këtij raporti dele se në asnjërinë nga materialet e dorëzuara nuk rezulton që në ditën e zgjedhjeve të ketë pasur në ndonjë vendvotim mbushje të kutive të votimit në mënyrë të kundërligjshme siç pretendon apeluesi.

Ndërsa lidhur me pretendimet e ankuesit që ndërlidhen me ditën e votimit, paneli pas shqyrtimit të afatshmërisë së kësaj pjesë të apelit, duke e vlerësuar, fazën në të cilën është tani procesi zgjedhor, vendosi si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, për arsye se pretendimet e apeluesit në këtë pjesë janë të **pasafatshëme**, për këto arsye:

Për të gjitha parregullsitë që i referohen, ditës së votimit e në këtë rast parregullsitë që pretendon apeluesi, me apel si dhe nga dëshmitë e bashkangjitura si deklaratat, fotografit dhe

formularët, rezulton fakti se kemi të bëjmë me parregullsi në ditën e votimit, dhe jo me parregullsi gjatë procesit të numërimit dhe bartjes së votave në rezultatet përfundimtare nga ana e KQZ-së. Ankesa për parregullsitë në ditën e votimit mund të paraqitet në PZAP, brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit dhe jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Apeli nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje është paraqitur pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 119 paragrafi 1 i LZP-së ku përcaktohet se " *Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqesë ankesë PZAP-it brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, dhe PZAP-i, do të vendosë për ankesën brenda 72 orëve nga koha kur është pranuar ankesa*", si dhe neni 5 paragrafi 3 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Rregullën Nr. 02/2015, ku përcaktohet: " *Ankesat në lidhje me procesin zgjedhor për ditën e votimit parashtrihen pranë PZAP-it, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit*". Në rastin konkret apeli është dorëzuar në PZAP, nga parashtruesi me datë 21.11.2021, dhe se nga përmbajtja e apelit rezulton se të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara nga ankuesi ndërlidhen me procesin e votimit.

Nga kjo rezulton se apeli i lartpërmendur është dorëzuar në PZAP, pasi që ka kaluar afati ligjor për të parashtruar ankesë në PZAP, për parregullsitë në ditën e votimit sipas dispozitës së lartcekur ligjore, kjo nga fakti se afati për paraqitjen e ankesës ka qenë me datën 15.11.2021 deri në ora 19:00, ndërkaq ankuesi apelin e tij e ka parashtruar në PZAP me datë 21.11.2021, që do të thotë se apeli është parashtruar pas afatit ligjor.


Meqenëse ankesa është e pas afatshme, Paneli nuk i shqyrtoi pretendimet tjera ankimore, pasi nuk u lëshua në vendosjen meritore në raport me këto pretendime,

Nga arsyet e theksuar me lart, e në kuptim të nenit 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.1145/2021 më datë 23.11.2021

Kryesuesi i Panelit
Burim Adem



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes pranimit të këtij vendimi.